

Msc . Pranvera Dingo

Pergjegjese e Sektorit te Sherbimeve dhe Publikimit ne APAAL(ASCAL)?

Msc Pranvera Dingo ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, në degën Financë duke marrë titullin Financiere.

Në periudhën 1989-1990 ka punuar në qytetin e Vlorës pranë Ndërmarjes Tregtare Vlorë (NTSH) si llogaritare e parë në Degën e Financës. Në vitet 1990-1994 transferohet në rrethin e Skraparit ku krijon familje dhe mban detyrën e N/kryetares dhe Kryetares së Degës së Financës në NTSH Skrapar. Në vitet 1994-1998 punon si Kryetare e Degës së Financës pranë Firmes private “Pasioni Shpk”, Tiranë dhe po në këto vite merr titullin “Ekspert kontabël”, detyrë të cilën e ushtron në vitet 1998-2000 ku punon si eksperte kontabël në Projektin e Kryeministrit për Firmat Piramidale.

Zj. Dingo prej vitit 2000-2014 ka një aktivitet të gjatë dhe të pasur në Sektorin Elektroenergjetik Shqiptar, në Korporatën Energjetike Shqiptare (KESH) dhe kompania energjetike private CEZ Albania, pjesë e stafit si kontabiliste dhe menaxhere në Departamentin Ekonomik (DEK) dhe atë të Kontabilitetit. Ajo ka një kontribut të rëndësishëm në organizimin e këtij sektori si pjesë e menaxhimit të pasqyrave financiare, përpunimin e saktë të informacionit në lidhje me transaksionet dhe standardizimin e raportimeve financiare.

Ajo ka qenë pjesë e shumë trajnimeve dhe *workshop*-eve që kanë të bëjnë me formimin e saj, si psh: për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, për Prokurimin Publik, për Procedurat e Prokurimit me Vlerë të Vogël, për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit, për Procedurat Standard të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, Standardizimin e Raportimit të të Dhënave dhe Pasqyrave Financiare, Risku, Menaxhimi, Përditësimi i Sistemit të Regjistrimit Qendror të Personelit (HRMIS), Praktikën e Zhvillimit dhe Menaxhimi i Ekipit, Nëpunësit e Burimeve Njerëzore për Modulin "Punonjësi", Teknikat menaxhuese bazë të personelit, etj. Prej vitit 2014, znj. Dingo drejton sektorin e Shërbimeve dhe Publikimit në APAAL/ASCAL.